



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 12941 Prot.

Vlorë, më 15.08. 2024

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ datë ____ 2024

“PËR VENDOSJEN E NJË PLLAKE NË TERRITORIN E LAGJES “UJI I FTOHTË” VLORË (TEK RRAPI DHE ÇEZMA)”

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, pika 1.7/b, neni 54 pika II, në kërkesën e Z. Vasil Velaj datë 20.05.2024, të miratuar nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë në datën 03.06.2024, si dhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë së bashku me dokumentacionin shoqërues, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 27.06.2024

VENDOSI:

1. Të miratojë vendosjen e një Pllake në territorin e lagjes “Uji i Ftohtë” Vlorë (tek rrapi dhe çezma) me mbishkrimin “Rrepet dhe Çezma janë kontribut i Z. Vasil Velaj”.
2. Për zbatimin e këtij Projektvendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.



KRYETAR
Ermal Dredha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 12941 Prot.

Vlorë, më 15.08. 2024

RELACION

MBI PROJEKTVENDIMIN

“PËR VENDOSJEN E NJË PLLAKE NË TERRITORIN E LAGJES “UJI I FTOHTË” VLORE (TEK RRAPI DHE ÇEZMA)”

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Vlorë

Në Komisionin Këshillimor për Titujt Vendorë Të Nderit të Këshillit të Bashkisë në datën 03.06.2024 është miratuar kërkesa e Z. Vasil Velaj i cili sikurse mund të jeni në dijeni ka realizuar me shpenzimet e veta sistemimin e territorit, mbjelljen e rrepeve si dhe ndërtimin e cezmës në lagjen “Uji i Ftohtë” Vlorë të cilat ekzistojnë edhe aktualisht.

Realizimi i punimeve me shpenzimet e veta është autorizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe Sektori i Urbanistikës së Bashkisë me autorizimin date 30.10.2001. Në kërkesën e tij Z. Vasil Velaj ka shprehur dëshirën që në atë territor konkretisht tek çezma ose tek rrepet të vendoset një pllakat ku të shkruhet “Çezma është kontribut i Biznesmenit Z. Vasil Velaj”. Nisur në vlerësimin dhe propozimin e Komisionit Këshillimor për Titujt e Nderit të Këshillit të Bashkisë të cituar më lartë edhe Administrata e Bashkisë konstaton se kjo kërkesë duhet të miratohet si një vlerësim për kontributin personal sado modest i cili tregon se në qytetin e Vlorës ka qytetar të cilët mund të kontribuojnë në funksion të interesave të komunitetit.

Miratimi i këtij projektvendimi do të shërbejë jo vetëm si respekt ndaj të interesuarit por njëkohësisht si model vlerësimi për të tjerë kontribues të cilët kanë mundësi dhe dëshirë të kontribuojnë në funksion të veprave publike.

Nga sa më lartë kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë të miratojë këtë projektvendim.
Ju faleminderit



KRYETAR
Ermal Dredha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Vasa Velaj, Nr. Prot. Post Data . .2024

Shkurtimi i lëndës gjerkesë

Për trajtim nga :	<u>DUI Shef Kabineti</u>
(struktura të tjera të ngarkuara	✓
Me porosi:	

Afati : Normal 7 ditë/ Prioritet 3 ditë/ urgjent brenda ditës/ pa afat/për dije/Tjetër ditë

Data 03.062024, Nr. Prot. 8551, Nënshkrimi : (TITULLARI) 03.06

Marrë në dorëzim : . .2024 Nënshkrimi :

Kalon për trajtim (struktura) : . .2024

Me porosinë :

Marrë në dorëzim : . .2024 Nënshkrimi :

Kalon për trajtim (struktura) : . .2024

Me porosinë :

Marrë në dorëzim : . .2024 Nënshkrimi :

Kalon për trajtim Specialistit : . .2024

Me porosinë :

Trajtimi i materialit përfunduar më : . .2024 Specialisti
Trajtimi i materialit pranuar më : . .2024 Eprori në shkallë hierarkike
Trajtimi i materialit miratuar më : . .2024 Eprori në shkallë hierarkike
Trajtimi i materialit miratuar më : . .2024 Eprori në shkallë hierarkike

Kërkesë
Kryetarit të Bashkisë së Vlorës
Zotit Ermal Dredha,

8581
03.06.2024

I nderuari kryetar,

I nënshkruari Vasil Velaj, banues në lagjen e Ujit të Ftohtë, me profesion argjendar, rrjedh nga familjet më të vjetra të qytetit të Vlorës, që kanë dhënë kontribut të veçantë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe ndërtimin e qytetit të Vlorës.

Duke qenë se Rrapi 285-vjeçar i Ujit të Ftohtë, i shpallur nga shteti “Monument kulture”, u shemb nga stuhitë e fuqishme të vitit 1998, një grup intelektualësh e banorësh të qytetit të Vlorës, si dhe Shoqatat Kulturore e Atdhetare “Ismail Qemali” dhe “Labëria” më kërkuan që simbolika e rrapit të ishte përsëri e pranishme pranë kroit në Ujë të Ftohtë.

Duke marrë iniciativën si biznesmen, atë kohë financova rregullimin e sheshit të shkatërruar nga trazirat e vitit 1997, ngritjen e çezmës dhe mbjelljen e rrepave, duke iu drejtuar me një kërkesë Bashkisë së Vlorës, e cila, më 30 tetor 2001, më autorizoi, t’i bëja punimet sipas miratimit edhe Seksioni i Urbanistikës.

Për këtë akt bujarie kanë shkruar disa gazeta në Tiranë dhe në Vlorë, RTSH dhe televizioni 6+1 dhanë disa intervista, si dhe vetë kryetari i bashkisë.

Qysh nga viti 2001 e deri më sot unë jam kujdesur për rritjen e rrepave dhe rikonstrukcionin e çezmës dhe të mjedisit dhe jam i kënaqur që janë në këtë gjendje të mirë, në shërbim të banorëve dhe turistëve që vijnë nga vende të ndryshme të Evropës.

Me këtë rast dëshiroj që në këtë vend të vendoset një pllakë ku të shkruhet: **“Rrepat dhe çezma e Ujit të Ftohtë u ndërtuan nga bujaria e biznesmenit Vasil Velaj, në vitin 2001”**, si shprehje e kujdesit qytetar.

Me respekt e mirënjohje
Vasal Velaj

Vlorë, më 20 maj 2024.



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA E Q. VLORE

(Zyra e Kryetarit)

(Sek. i Urbanistikës)

Vlore më 30/10/ 2001.

A U T O R I Z I M

Anterishtet noti Vasiljevi Velaj, burre ne lëvizjen "Ujit i Ptohte" Vlore per mbjelljen e rrapit pranë stacionit të autobusit të "Ujit të Ptohte", ne iniciativen e tij personale.

Te gjitha shprehimet financiare do te perballihen nga vete noti Vasiljevi Velaj.


PRERJ. SHK. TE URBANISTIKES

ARK. SAMI CANAJ



KRYETARI I BASHKISE QYTIMIT VLORE

NIKO VEIZAJ



RRAPI MADHËSHTOR I UJIT TË FTOHTË - 250 VJEÇAR

Aty nga viti 1750, thonë historianët, në tokat e Velajve në Ujet e Ftohtë na mbi një rrap. Vitet pas tij shtoheshin dhe rrapit rritesh, vendi aty rrotull mori një bukuri tërësisht në përallë. Rrapi përkarshi kish detin dhe vetë ish si një vend i bekuar nga perëndia. Kurora e atij rrapit mbliqhte për çdo vit e dekada kohet, epoka dhe i regjistronte në trungun e tij "rrathëvjetor". Sa çudi asnjë nga vlonjatet nuk i di se çfarë shkruheshin atje.

Kam parë me sytë e mi vlonjatet, thotë rrapit ujiftohtas, kur tek mua lodronin të gjithë femijet e vlonjateve, qytetarë dhe gjithshqiptarë. Sa e sa herë ka lozur edhe Vasili i Velajve rrotull trungut tim, dhe bashkë me të gjithë vlonjatet. Une i buzeqeshja viteve. Sa e sa herë pushonte Beqir Velua i parë, ky trim kryengritës në shekullin e kaluar, ai kërkonte lirinë në vite. Ishin marinarët e stuhive të Adriatikut që strehoheshin nën ato trungjet e atij rrapit ujiftohtas. Sa shumë krenoheshin Velajtë për keto bemat e tij. Tymoste duhan Beqiri dhe si për ta përshëndetur Rrapin, i shihte degët e tij. Atij i vinte në veshe kushtrami për lirinë e Atdheut. Mbahu forte, more burrë i dheut, i thosh rrapit dhe përçillte jehonën e viteve diku në epokat e tjera. Në ato hijet e viteve të errëta mjerëzit me mushkat e tyre të qumështit sillnin pranë këtij rrapit qumështin e Shashicës. Akoma vijnë jehona e atyre këmborave të bagetive, dhe

te Shkollës Tregtare niseshin nëpër ato rrugët gjarpërore dhe mbrinin aty për të sfiduar kohën e pushuesve. Ata i thirri vetë koha me tingujt e luftes për liri, dhe ata më vonë mbushën çetat partizane. Rrapi brenda vetes ka shumë legjenda. Thonë se dhe Ali Pasha i Tepelenes ka pushuar aty. Ishte koha e osmanllinjve vite më parë nga fundi shekullit kur ata në degët e atij rrapit varnin lehtëri dhe mallakastriotet vetëm e vetëm se ata donin lirinë. Akoma vlonjateve u vijnë jehonat e trimërive djaloshare. Ishin dhe vitet e plakura të atij rrapit kur në ato degët e tij më 1967-68 kaloi rufeja që karbonizoi një djalosh. Ja dhe gjurma tjetër që vetë ai rrap tash i plakur, mbane në trungun e tij në fund një tub uji, që e asfikson dhe ndjeu se tepërmi dhimbjen e viteve. Ai rrap i plakur një ditë u rrezua, u rrezua keqas sa që ata roje që i ndjehen rrenkimet e tij ato krijesat e fundit e pane ndoshta se ai rrap u rrezua si një luan i plagosur, për vdekje shembli, ato dyqane qelloi lehtës mbi to. Me pas të gjithë e pane se ai kish rënë dhe vendi ishte shemtuar, në trungun e tij në fund gurgullonte dhimbshëm Uji i Ftohtë sikur akoma gulçonte. Ishin lotët e fundit të lamtumirës të atij plaku. Sa u pikëlluan vlonjatet të gjithë, dhe Vasili kur e pa u ligështua por vendosi dhe na pruri sot me krenari një Rrap Djalosh, pikërisht aty ku ai rrap plak la testamentin e tij. Ja pra vetë ky rrap i mi, do të shkruaj në vitet e lirisë, një histori

Žotit Zurnal Dječaka
Mlynčan i Babišev Vlore

Vlore
(Per komisijom i Vloreskim to byvanje)

Perdi 069 24 412 86

Dječak
Vasil Vela
Lopra "Uji i Fhalhos"
Pravni sekretar Mlynčan